



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 168 prot

Datë, 01.11.2022

URDHËR

Nr. 79 datë 01.11.2022

“FILLIMIN E PRANIMEVE TË APLIKIMEVE, NGA ANA E FAKULTETEVE TË UART, PËR STUDENTËT TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIMIN OSE REDUKTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Në zbatim të nenit 112 të ligjit nr 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”(i ndryshuar); VKM nr. 251, datë 27.03.2020 për “NJë ndryshim në VKM nr 269, datë 29.03.2017 për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen ng tarifa vjetore e shkollimit”Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, VKM nr 40 datë 23.01.2019

URDHËROJ

1.Fillimin e pranimeve she shqyrtimeve të aplikimeve, nga ana e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023

2.Personat përgjegjës që do të merren me administrimin e procesit në çdo Fakultet, janë si më poshtë:

Nermin Zebi

Arta Dashi

Enela Mastori

Fakulteti i muzikës

Fakulteti I Arteve të Bukura

Fakulteti I Artit Skenik

nermin_zebi@yahoo.com

arta_dashi@yahoo.com

enelamastori@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Studentët duhet të dorëzojnë aplikimet/formularin si dhe gjithë dokumentacionin provues fizikisht dhe në e-mail të personave të përcaktuar në pikën 2.

4. Grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”(i ndryshuar) dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, publikuar në web-in e UART.

5. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit, në zyrën e protokollit në Rektorat nga grupi i punës është data 25.11. 2022

6. Personat përgjegjës i regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë dhe pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga studentët, përcaktojnë studentët që përfitojnë ose jo përjashtim apo reduktim të tarifës së shkollimit për vitin akademik 2022-2023. Materiali i përgatitur duhet të dërgohet sektorit juridik për verifikim brenda dates 1 dhjetor 2022.

7. Sektori juridik, pas verifikimit të dokumentacionit të grupit të punës, përgatitit informacionin për Administratorin e Universitetit të Arteve

8. Afati i fundëm për mbarimin e punës dhe dorëzimin e materialit përfundimtar Administratorit të UART nga Sektori Juridik është data 05 dhjetor 2022

9. Në çdo rast, kur një aplikant paraqet dokumentacionin/formularin për përjashtim/reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023 që në të ardhmen rezultojnë jo ligjorë, përgjegjësia bje mbi studentin i cili penalizohet

10. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të web-it të Universitetit të Arteve dhe t’ju bëhet me dije studentëve dhe nëpërmjet afishimit në ambiente të dukshme të Fakulteteve të UART

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, Dekanët, zyra e protokollit në UART, personat përgjegjës në cdo Fakultet si dhe sekretaritë e Fakulteteve për njoftimin dhe shpalljen e këtij urdhëri

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot ÇAUSHI

REKTOR